REPUBLIKA E KOSOVËS
Sh.f. "Iliria"
Nr. 121
Data 15.XI.1994
Prishtinë

KËSHILLIT KOMUNAL PËR FINANSIM
P R I SH T I N Ë

Lënda: Kërkesë për finansimin e një vendi të ri të punës - punëtore teknik

Shkolla fillore "Iliria" në Prishtinë, zhvillon mësimin e vetë në tri ndërrime, në lokal me sipërfaqe prej 2421.06 $m^2$ / mësojtoret, kabinetet, salla e ed.fizike e lokalet tjera ndihmëse/.

Deri me tani kjo sipërfaqe është pastruar nga 6 punëtore teknik / 3 finansohen nga drejtoria serbe kurse 3 nga Këshilli për finansim/ ku secili është dashur të pastroi nga 403.51 $m^2$.

Duke pasur parasysh sipërfaqen 2421.06 $m^2$ dhe punën në tri ndërrime, në këtë shkollë një punëtori teknik, sipas nenit 42 të Pregullores për kompenzimin material të punëtorëve duhet ti takoj 250 $m^2$ sipërfaqe për pastrim. Sipas kësaj shkollës do ti takonin 9.68 norma, mirëpo duke patur parasysh kushtet materiale në këshill kërkojmë që shkollës ti lejohet bile një vend pune në mënyrë që bile çdo punëtori teknik ti takoi 350 $m^2$ / njejt sikur shkolla të punoi në dy ndërrime e jo në tri/.

Besojmë se këshilli do të gjejë mirëkuptim dhe do të lejoj finansimin e këtij vendi të ri punës dhe atë prej datës 1.XII.1994.

Ju falenderojmë për bashkëpunim dhe mirëkuptim!

DREJTORI I SHKOLLËS
/ Mahmut Breca /

Nëse këshilli konstaton se me të vërtetë i takon një vend i tillë i punës shkollës, atëherë duhet ta pranojë.